



*SHKOLLA ME PËRBËRJE ETNIKE TË PËRZIER
– PUNËTORIA KU MËSOHET DHE KULTIVOHET
KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRETNIK*

QENDRA MAQEDONASE PËR ARSIMIM QYTETAR (QMAQ)



***SHKOLLA ME PËRBËRJE ETNIKE TË PËRZIER
- PUNËTORIA KU MËSOHET DHE KULTIVOHET KOMUNIKIMI
DHE BASHKËPUNIMI NDËRETNIK***

Shkup, 2006

SHKOLLA ME PËRBËRJE ETNIKE TË PËRZIER - PUNËTORIA KU MËSOHET DHE KULTIVOHET KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRETNIK

Redaktor dhe konsulent profesional:
Slobodanka Ristevska

Botues:
Qendra maqedonase për arsimim qytetar (QMAQ)



Botimi i broshurës financiarisht është ndihmuar nga:
Shërbimet katolike për ndihmë (CRS)



HYRJE

Kjo broshurë paraqet rezultatin e projektit, , Komunikimi dhe bashkëpunimi ndëretnik në mes nxënësve në shkollat me përbërje të përzier etnike", të cilin e ka realizuar MCGO, financuar dhe përkrahur nga CRS (Shërbimet katolike për ndihmë), në bashkëpunim me katër shkolla fillore me përbërje të përzier etnike, 37% Maqedonas, 36% Shqiptarë, 21% Turqi, 6% Boshnjakë edhe në atë në: Sh. f „Rajko Zhinzifov"- Shkup, Sh. f „Alija Avdoviq" - fshati Batincë të Shkupit, Sh. f. „Marshali Tito" - Strumicë dhe Sh. f. „Goce Dellçev" - Vasilevë, PU fsh. Angelci.

Shembulli - i tërë grupi me të cilin u realizuan aktivitetet e projektit ishte i përbërë prej 206 nxënës, respektivisht me 9 paralele, nga të cilat, dy paralele kanë qenë klasa e katërt, tri paralele të përziera, dy paralele të klasës së shtatë dhe dy paralele me përbërje të përzier me nxënës të klasës së shtatë dhe tetë.

Projekti u realizua në periudhën prej muajit tetor të vitit 2005 gjer në muajin shtator të vitit 2006.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit ka qenë përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit ndëretnik në mes nxënësve në shkollat fillore me qëllim që të përkrahet zhvillimi i bashkëpunimit dhe tolerancës në mes bashkësive ndëretnike në Republikën Maqedonisë.

Qëllimet e veçanta janë:

- Zvogëlimi i tensioneve në mes nxënësve me përkatësi të ndryshme të bashkësive etnike;
- Përgatitje e teknikave interaktive gjatë realizimit të aktiviteteve me përmbajtje për forcimin e komunikimit multi-etnik, bashkëpunimit dhe tolerancës.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit u realizua edhe trajnimi i 16 mësimdhënësve dhe punëtorëve profesional nga shkollat e lartpërmendura. Pas trajnimit të tyre, si ekip, së bashku me nxënësit e tyre, aktivitetet e tyre i realizuan duke i prezantuar vet ata gjatë trajnimit, si dhe aktivitet e parapara në Listën e aktiviteteve e cila u është dhënë atyre me udhëzime për përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndëretnik.

Duke falënderuar motivimit, angazhimit dhe përvojave të mësimdhënësve dhe punëtorëve profesional, aktivitet e planifikuara u realizuan me sukses.

Nga raportet të cilët i dorëzuan ekipet punuese të shkollave, mund të konstatojmë se projekti e ka arritur qëllimin, gjegjësisht, ai e ka stimuluar afrimin e nxënësve me prejardhje të ndryshme etnike nëpërmes vendosjes së mekanizmave për tejkalimin e pengesave gjuhësore, religjioze dhe kulturologjike. Konstatimi se qëllimi i projektit është realizuar në tersi, e vërtetojnë deklaratat e anëtarëve të ekipeve të shkollave të cilat kanë punuar në projekt dhe në bazë të deklaratave të prindërve të nxënësve.

- „Shoqërimi i nxënësve nga bashkësitë e ndryshme etnike (Maqedonas, Shqiptarë, Turq, Boshnjakë, Romë, Vlleh) është rritur, gjegjësisht është thelluar dhe ka arritur nivel të lartë, gjë që, ajo është reflektuar edhe tek ata të cilat nuk janë përfshirë në aktivitetet por të cilat kanë kërkuar edhe ata të përfshihen.”
- „Nëpërmes këtij projekti u zhvillua një komunikim i shkëlqyer në mes nxënësve, në mënyrë që feja dhe nacionaliteti nuk kanë paraqitur ndonjë pengesë për komunikim të lehtë dhe të mirë në mes tyre.”
- „Këto aktivitete jashtë mësimore janë realizuar në një atmosferë të një lidhje reciproke, afërsi, gjë që kjo ka kontribuar që nxënësit të mësojnë diçka edhe më shumë nga gjuha e të tjerëve.”
- „Ekipet e shkollave i përsosën vet metodat për përparimin dhe mirëkuptimin ndëretnik. Kështu, të gjithë ata të cilat u kyçën në projekt (nxënës, mësimdhënës, punëtorë profesional, prindër dhe drejtorët) punuan me një vullnet të mirë, përgjegjësi dhe entuziazëm.”



Një prind i një nxënësi të klasës së shtatë tha:

- „Jam e kënaqur se fëmija im pas organizimit të punëtorive që u realizuan në shkollë, tani në shtëpi kthehet me përshtypje pozitive. Jam krenare sepse vet ai ka ardhur në përfundim se të gjithë fëmijët e shkollës së tij janë të njëjtë, janë të njëjtë në shumë gjëra, ndërsa në shumë gjëra edhe dallohen, gjë që tek ai, janë zvogëluar paragjykimet”.

NOCIONET QË DUHEN TË DIJEN QË MË MIRË TË KUPTOHET TOLERANCA NDËRETNIKE

„Asnjëherë dhe askund në botë nuk ka dy mendime të njëjta, ashtu si nuk ka edhe dy fije qime të njëjta, por as dy kokrra të njëjta. Dallueshmëria është cilësia më universale.”

Montaigne, filozof francez

Toleranca ndëretnike

është respektimi i të drejtave të të tjerëve. Njërzit janë të njëjtë, por jo edhe identik. Ata dallohen sipas gjinisë, moshës, nacionalitetit, gjuhës, religjionit, kulturës. Që të arrihet paqe, drejtësi dhe përparim social, nevojitet respektimi i dallueshmërisë, respektimi i kulturave. Ky respektim reciprok do të thotë tolerancë ndëretnike.

Kultura

është mënyra e veçantë e jetës, sipas së cilës pjesëtarët e shoqërive të ndryshme, grupet dhe kulturat e ndryshme shoqërore dallohen në mes vete. Nocioni kulturë përfshinë:

- **sistemin e vlerave** (të orientuarit e sjelljes njerëzore, ndërtimi i qëndrimeve, marrëdhënieve dhe shprehive);
- **të organizuarit, realizimi dhe rezultatet nga aftësitë dhe veprimtaritë njerëzore** (sendeve, objekteve, ndjenjave, diturive, shkathtësive dhe sjelljeve);
- **sistemin e simboleve** (gjuhën, gjetet, mënyrën e sjelljeve, mitet, idetë dhe gjërat e shenjta);
- **memorien kolektive** (kontinuiteti historik dhe dituritë e transmetuara dhe zhvilluara, të menduarit dhe përvojat);
- **normat, me ndihmën e të cilave realizohen vlerat, ndërsa mbrohen interesat e shoqërisë** (tregojnë se ku dhe si duhet të sillen njërëzit).

Kultura ndihmon që të ndërtohet identiteti kulturor.

Identiteti kulturor

është ndjenjë që i takon një kulture, mirëpo është edhe ndjenjë që posedon individi, me veti të veçanta që nuk përsëritet. Kulturat aq sa janë të njëjta, bashkëpunimi dhe mirëkuptimi do të jetë më i lehtë midis pjesëtarëve etnike të atyre kulturave, dhe anasjelltas, aq sa kulturat janë me dallime më të mëdha në bazë të vlerave dhe shkallë dalluese të zhvillimit, bashkëpunimi komplikohet.

Shoqëritë multikulturore

janë shoqëri që kanë kultura të ndryshme që dalin nga grupe të ndryshme etnike ose religjioze. Si pasoj e lëvizjeve të migracionit, sot vetë në disa vende të vogla ekzistojnë shumë kultura të ndryshme. Vetëm një numër i vogël i vendeve janë mono-kulturore. Shumë vende që dikur kanë qenë si vende mono-kulturore, ndërkohë janë bërë vende multikulturore.

Multikulturalizmi

nënkupton toleranca, shkëmbimi dhe bashkëpunimi midis kulturave që janë prezentë në një mjedis shoqëror, por edhe në botë, pa marrë parasysh se a janë të njëjta apo dallohen ato në mes tyre.

Etnocentrizmi

është zmadhimi i vlerave të kulturës së vet për shkak të mbrojtjes së identitetit të vet kulturor, kurse nënçmimi i vlerave të kulturës së tjetrit.

Relativizmi kulturor

nënkupton kultura të njëllajta, gjegjësisht është qëndrimi, se të gjitha kulturat janë të njëjta me vlera, dhe se asnjëra kulturë nuk ka të drejtë të çmojë kulturën tjetër sipas kriterëve të veta.

Universalitetet kulturore

quhen elementet që janë të përbashkëta për të gjitha kulturat. Ato janë: lidhjet familjare, ndarja e gjeneratave, adaptimi i shprehive higjienike, besimet, vallëzimet, puna e përbashkët, arsimimi, zburimi i trupit, organizimi shoqëror, matja e kohës, shprehitë, rregullat për ushqim, ndarja punës, të drejtat personale etj. Universalitetet kulturore janë bazë për mirëkuptim ndërkulturor, respektivisht krijimin e kulturës së përgjithshme njerëzore universale.

SHKOLLA ME PËRBËRJE TË PËRZIER ETNIKE ËSHTË PUNËTORI NË TË CILËN MËSOHET DHE KULTIVOHET KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRETNIK

Puna edukativo- arsimore në shkolla realizohet në mënyrë komplementare, nëpërmes mësimt dhe veprimtarisë jashtë mësimore. Në mësim, funksion primar ka arsimimi, kurse në veprimtarinë jashtë mësimore ka edukimi. Në kuadrin e mësimt bënë pjesë edhe ora e kujdestarisë. Ajo, në dallim nga ora e rregullt mësimore, e cila në mënyrë decide është e planifikuar, është e organizuar dhe artikulluar, lejon realizimin e përmbajtjeve edukative dhe aktiviteteve për arritjen e qëllimeve të caktuara edukative.

Aktivitetet dhe përmbajtjet të parapara me projektin „Komunikimi dhe bashkëpunimi multietnik midis nxënësve në shkollat e përziera etike“, janë realizuar në orën e kujdestarisë (me nxënësit e klasës së shtatë dhe klasës së tetë), dhe nëpërmes aktiviteteve jashtë mësimore edhe atë nga fushat: aktivitete të lira të nxënësve, punës së dobishme dhe punës prodhuese shoqërore; bashkëpunimi i shkollës me mjedisin lokal.

2.1 PËRMBAJTJET E REALIZUARA NË ORËN E KUJDESTARISË

Orën e kujdestarisë me nxënësit e klasës së shtatë dhe tetë, ekipet e shkollës vendosën ta shfrytëzojnë për realizimin e këtyre përmbajtjeve dhe aktiviteteve:

NJË DITË NGA JETA IME

Teknikat e punës: puna në grupe, tekst- metoda dhe bisedë

Brenda 15 minutash secili nxënës të përshkruaj një ditë nga jeta e ti, j nga një moment që nga zgjimi i tij nga krevati e gjer në mbrëmje kur do të flejë. Në këtë interval kohe do të numëroj të gjitha aktivitetet që i ka bërë, gjërat që i ka shfrytëzuar, prodhuesi i tyre marka dhe vendi ku janë prodhuar ato.

Nxënësit e paraleles do të ndahen në katër grupe. Anëtarët e grupeve do të lexojnë tekstet e veta, dhe në një fletë do të shënojnë prodhuesin, markën dhe vendin që janë prodhuar sendet të cilat i kanë shfrytëzuar.

Përfaqësuesi i secilit grup do ta lexoj atë që e ka shënuar për sendet e përdorura, markën dhe vendin ku janë prodhuar.

Mandej do të vijojë diskutimi për lidhshmërinë midis tyre dhe lidhjet e njerëzve dhe shteteve nga e gjithë bota.

SHËMBULL: NJË DITË NGA JETA IME

Nga cingërima e ziles së orës, të markës ESEN e sjellë nga SHBA-të, u zgjova nga një ëndërr e thellë. Përgjumshëm dhe i mërzitshëm u shtrira në krevatin tim të vjetër komod, prodhuar nga LESNINA - SLLOVENISË, e largova mbulesën LIO nga KROACIA, hyra në tualetin me pllaka ITALIJANE. U pastrova me sapunin tim të adhuruar për fëmijë nga MERIMA - KRUSHEVC, të cilin e përdori që në kohën sa e mbaj mënd vetveten që nuk do të ndërroja në asnjë tjetër. Të them se në sirtarët e mijë, me siguri kam rreth tridhjetë copë si rezervë, që mos ndalet importi i tyre. Çka din? U lyra me krem AFRODITA me aloe, nga SLLOVENIJA, i lava dhëmbët me pastë BIODENT të LEK-LUBJANA, u kreha dhe u stërpika me reshin për flokë INTESA - ITALI.

I zhvesha rrobat e natës DO-RE nga TURQIA, vesha kostumën nga BELE - SHTIP, këpucë nga PEKO - SLLOVENIA, mora çantën të MONA - BEOGRAD dhe me veturën RENO KLIO - FRANCË vajta në punë.

Aty menjëherë u ula në tavolinën e punës nga MEBLO - LUBJANA dhe hapa librin e metodikës, „BAZAT E DEMOKRACISË" nga grup autorësh nga KALABASAS-KALIFORNI.

Stilolapsi me të cilën shkruaj është nga GJERMANIA. Për pushim për kaffall mora një simite nga ARGIRICA, nga furra private e MANASTIRIT dhe një jogurt IMB-MLEKARA - MANASTIR.

Në të kthyer në shtëpi, me qenë se nuk kisha drekë të përgatitur, hyra në VERO dhe bleva patate pire të një marke GJERMANE dhe SLLOVENE.

Në shtëpi e serova në tavolinë me garniturën MURALES - SLLOVENI, në pjata të ZAJAÇARIT - SËRBI, përdora salfeta PALOMA. Enët i lava me PALMOLIVE - nuk e di se nga është.

U ula, e lëshova televizorin LGJ në kanalën HALMARK, e shikova filmin. Në një moment ndjeva ftohët dhe e mora batanijen e leshtë nga TETEKSI - TETOVË. Posa fillova ta shfletoj numrin më të ri të revistës BURDA - nga GJERMANIA, u dëgjua zilja me disa takte muzikore me " Katër stinët e vitit" nga Gj. Vivaldi e sjellur nga GREQIA.

Për të krijuar atmosferë më të këndshme lëshova CD nga grupi LEGJENDA nga BEOGRADI. Motra ime më tregoi se në shitoren TERA NOVA, përndryshe shitore GREKE, ka zbritje solide të gardërobës dimërore.



BISEDE PËR KULTURËN DHE MULTIKULTURËN

Teknikat e punës: Prizma

Secili nxënës do të merr nga një formular nga teknika Prizma. Për tu sqaruar nxënësve më mirë, mësimdhënësi mund të përdor edhe grafoskopin dhe termofolinë në të cilën është vizatuar formulari i Prizmës, ose të shërbehet me formularin e përgatitur për punën që do ta bëjë me nxënësit.



Teknika prizma bazohet në asocim. Prandaj, nxënësit nuk duhet të kenë para njohuri të posaçme për atë se çka do të mësohet apo diskutohet, respektivisht për atë që do të plotësohet. Nxënësit në fushat e katërkëndëshit kënddrejtë do të shënojnë nga dy fjalë, varësisht se çka u është kujtuar atyre në mend kur e kanë dëgjuar fjalën **kulturë**. Mandej procedura do të përsëritet për secilën fjalë të shënuar. Domethënë, në secilën fushë të katërkëndëshit kënddrejtë, nxënësi shënon nga një fjalë që do të ketë asocimin në fjalën të cilën e ka shënuar më përpara. Procedura mund të përsëritet, kurse prizma mund të zgjerohet, varësisht nga moshja e nxënësve dhe nga njohuritë mbi nocionin që punohet prizma. Mandej vijon mbledhja, integrimi i të dy fja-

lëve. Fjala e cila i asocion fjalët e shënuara të më poshtme, shënohet në fushën e më poshtme të katërkëndëshit kënddrejtë. Procedura do të përsëritet gjer sa nuk arrihet në një fjalë. Fjala e shënuar KULTURË, analizohet me fjalën e fundit e cila është fituar si rezultat i asocimit të të dy fjalëve të shënuara.

Në orën e ardhshme në vijim, do të përsëritet procedura e njëjtë edhe për nocionin multikultura.



TEKNIKA NË FORMË PRIZME



□ **NË ÇFARË SHOQËRIE DËSHIRONI TË JETONI: MONOKULTURORE APO MULTIKULTURORE?**

■ **Teknikat e punës: puna në grupe, stuhi idesh dhe diskutime**

Nxënësit e paraleles ndahen në katër grupe. Dy grupet e nxënësve do të mendojnë dhe diskutojnë për anët pozitive për shoqëritë multikulturore, ndërsa dy grupet tjera do të mendojnë dhe diskutojnë për anët negative të atyre shoqërive. Grupet janë vendosur në një distancë që të mos pengojnë njëra tjetrën.

Gjatë punës së tyre nxënësit do të nxiten apo stimulohen që të shfrytëzojnë teknikën „stuhi idesh”: secili anëtar i grupit duhet të shpreh sa më shumë ide, kurse ato do të shënohen në fletë, mirë por ato në një moment nuk do të vlerësohen (nuk do të tregohen se a janë të mira apo të këqija).

Gjersa do të shprehen të gjitha idetë, dmth. askush nuk ka për të shprehur ide tjera, atëherë do të fillojë diskutimi. Me marrëveshje të përbashkët do të vendoset se cilat ide do të shënohen në një fletë tjetër që të prezantohen para tërë grupit. Për atë se çka do të lexohet para grupit tjetër do të lexoj përfaqësuesi i grupit.

Mësimdhënësi, bashkë me grupin do t'i komentoj të gjitha mangësitë dhe prioritetet, do t'i përmbledh dhe do t'i shënojë në dërrasë në dy kolona: në një anë do të shënoj mangësitë, kurse në tjetrën prioritetet.

Pas aktivitetit të këtillë me të gjithë nxënësit e grupeve do të diskutohet lidhur me këto pyetje:

- *Në çfarë shoqërie dëshironi të jetoni, në shoqëri monokulturore apo multikulturore? Pse?*
- *Mangësitë apo dobësitë të një shoqëria multikulturore a janë përparësi për shoqërinë monokulturore?*
- *Përparësitë e shoqërisë multikulturore a janë dobësi apo mangësi të shoqërisë monokulturore?*
- *Në çfarë kushtesh mund të vijë në shprehje përparësitë e një shoqërie multikulturore?*



SI MUND TË KONTRIBUOJ PËR NJË RESPEKT MË TË MADH PËR DALLIMET NË FAMILJE, SHKOLLË, FQINJËSI, NË VEND DHE NË BOTË?

■ ***Teknikat e punës: individuale, puna me grupe, diskutim dhe dramatizim***

Fillimisht, secili nxënës duhet të shënoj nga dy mënyra apo mundësi se si **ai mund vet të shënoj, pavarësisht nga të tjerët, të kontribuoj** për respektim më të madh të dallimeve, por jo si pjesë e grupit, - por vet ai në emër të tij. Mënyrat duhet të orientohen në drejtim të:

- anëtarëve të familjes,
- shokëve,
- fqinjësisë,
- qytetarëve të vendit,
- qytetarëve të botës.

Me njërin mënyrë **nxënësi duhet të tregoj respekt më të madh** personal ndaj anëtarëve familjes, shokëve, fqinjëve, ndaj qytetarëve të vendit dhe të botës.

Me mënyrën tjetër ai **duhet të ndikoj mbi të tjerët** (anëtarët e familjes, shokëve, fqinjëve, qytetarëve të vendit dhe të botës) që tek ata të rritet dhe të zhvillohet respekti ndaj të tjerëve.

Mandej, mësimdhënësi formon katër grupe me të cilët do të diskutoj për propozimet e veçanta konkrete të cilat i kanë shënuar nxënësit. Në kuadrin e grupit, vlerësohet konkretizimi dhe realizimi i tyre, mandej përgatitet lista e përbashkët e propozimeve në të cilën mund të plotësohet edhe me propozime të reja, nëse ato do të dalin nga diskutimet brenda vet grupit.

Përfaqësuesi i secilit grup do ta prezantoj listën e propozimeve.



■ **E KALUARA KULTUROLOGJIKE E TRI GJENERATAVE**

■ **Teknikat e punës: puna me grupe, analizë dhe krahasime**

Paralelisht punohet në dy paralele të njëjta me përbërje të njëjtë etnike.

Nxënësit e paraleles ndahen në katër grupe. Secili grup duhet të bisedoj apo të zhvilloj diskutim për jetën në rini të të tri gjeneratave në mënyrë retrospektive (për gjyshërit dhe gjyshet e nxënësve, për prindërit e tyre dhe për vetveten). Nxënësve duhet tu shpjegohet se duhet të bisedojnë për: **kushtet hapësinore ku jetojnë** (në çka kanë jetuar: në shtëpi, banesë); **numrin e anëtarëve të familjes, ushqimin** (cilat ushqime kanë dominuar në jetën e përditshme, kur dhe si kanë ngrënë gjatë ditës); **veshja** (çka kanë veshur apo mbajtur, çka ka qenë në modë); **arsimimin** (shkalla e arsimimit, zanatet); **shfrytëzimi i kohës së lirë** (si janë argëtuar, ku kanë shëtitur, çka kanë bërë); **pushimin vjetor** (a kanë shkuar, ku dhe me cilin); **festimet e festave** (cilat festa i kanë festuar, si dhe pse); **vizita e objekteve fetare** (sa herë i kanë vizituar, me ç'rast i kanë vizituar ato); **vlerat** (cilave vlera u kanë kushtuar kujdes më të madh, pasuria, ndershmëria, fjala e dhënë); **nevojat** (të domosdoshme, luksoze); **idealet** (çka kanë dashtë të mbërrin në jetën e tyre për vete dhe për fëmijët e tyre, pasardhësit).

Anëtarë e grupit bëjnë krahasimin e kulturës së jetës të të tri gjeneratave. Secili grup, në një fletë të madhe përgatit tabelë në të cilat do t'i paraqet elementet e veçanta të të jetuarit të tyre.

Në orën e ardhshme vijuese, të dy paralelet të cilat kanë punuar në retrospektivë kulturologjike, do të bashkohen në orë të përbashkët ku do të bëhet prezantimi i nga një tabele nga secila bashkësi etnike. Mandej, bëhet krahasimi i jetesës së secilës gjeneratë të të dy bashkësive etnike.



RETROSPEKTIVA (E KALUARA) KULTUROLOGJIKE E TRI GJENERATAVE

Elementet	Gjyshja - Gjyshi	Prindërit tanë	Ne
Kushtet hapsinorei	Shtëpia	Banesa	Banesa
Anëtarët e familjes	7	4	4
Ushqimi	Peta, fasule, oriz	Mish, brumë	Piza, hamburger
Veshja	Kostume, xhemperë	Xhins pantallona, këmisha, pantallona	Mini-brekë, kanotiere, xhins pantallona
Arsimimi	Mesatare	Mesatare	Iartë
Koha e lirë	Thurja	Rrallë e kanë	Dëgjojmë muzikë argëtim në disko
Pushimet vjetore	Rrallë	Çdo vit	Planifikoj në Havai
Festimi i festave	Ramazani, Bajrami, Kurban Bajrami	Ramazani, Bajrami, Kurban Bajrami	Përmbahemi ndaj traditave
Pagëzimet, dasmat	Tradicionalisht, sipas traditave të vjetra	Tradicionalisht, me ndryshime të vogla	Më moderne, pa tradita
Vlerat	Respekt ndaj të vjetërve	Arsimimi, Respekt nda të vjetërve	Arsimimi, Veshje e mirë
Nevojat	Shtëpi e ngrohtë, familje e mirë	Shtëpi e ngrohtë, familje e mirë	Telefona, kompjuteri
Aspiratat	Shtëpi e mirë, ushqimi	Arsimimi, puna	Arsimimi, automobila luksoze

*Shembull nga "Retrospektiva e tri gjeneratave"
nga puna me grupe dhe me nxënës me mësim në gjuhën shqipe*

RETROSPEKTIVA (E KALUARA) KULTUROLOGJIKE E TRI GJENERATAVE

Elementet	Gjyshi - Gjyshja	Prindërit tanë	Ne
Kushtet hapësinore	shtëpia	banesa	banesa
Anëtarët e familjes	5	4	4
Ushqimi	Peta, gjellërat, gjellërat e ziera, grosha	Bizelja, peshku	Spinaqi, ushqime të detit
Veshja	Kostumet, fustanet	Fustanet, Bluzat, xhemperët	Veshjet sportive, kanatiere(majca), tude (trenerka), xhins pantallonat (farmerka)
Arsimimi	E mesme	I lartë	I lartë
Koha e lirë	Shumë	Pakë	Pakë
Pushimi vjetor	Rrallëherë	Ndonjëherë (kanë shkuar në liqe apo në det)	Planifikoj: San Francisko, Havai
Festimet dhe festat	Tradicionale festat: Krishtlindjet, Pashkët, të rinjtë me shumë mysafirë	Festohen në mënyrë moderne: Krishtlindjet, Pashkët, Shën Atanasi	Në mënyrë më moderne do t'i festoja: Krishtlindjet, Pashkët, Shën Atanasin, Shën Nikollën, me më pak mysafirë
Pagëzimet dhe dasmat	Dasma me tradita të vjetra, pagëzime në kishë	Dasma sipas traditave më të reja, me pagëzime në kishë	Planifikoj dasmë në ujdhesat e Bahameve
Vlerat	Edukim me nderim ndaj më të moshuarve	Respekt ndaj të moshuarve	Respekt ndaj prindërve të mi
Nevojat	Ushqimi, relaksim, programe në TV	Ushqimi, Programe TV, kompjuter	Ushqim i shëndetshëm, kompjuter, internet
Aspiratat	Edukim i mirë, formimi i familjes	Të shprehurit e marrëdhënieve të mira familjare	Të arrijë arsimim të lartë dhe vazhdimisht të përsosëm

*Shembull nga "Retrospektiva e tri gjeneratave"
nga puna me grupe dhe me nxënës me mësim në gjuhën maqedonase*


PËRPUNIMI I PORTFOLIOS PËR RELIGJIONIN, USHQIMIN DHE KULTURËN E BASHKËSIVE ETNIKE QË JETOJNË NË MAQEDONI

■ **Teknikat e punës: puna me grupe, mbledhja e të dhënave, analizë**

Pavarësisht nga përkatësia etnike, të gjitha paralelet mund të formojnë dhe të përpunojnë portfolio për tri segmentet nga jeta e bashkësisë së vet etnike, edhe atë për: religjionin, ushqimin dhe kulturën. Për këtë nevojiten tri hamera të mëdha apo çfarëdo qoftë letër, fotografi, vizatime, tekste të shkruara, fllomasterë, ngjitës.

Në secilën pano, me ndihmën e fjalës së shkruar, fotografive (vizatimeve, pjesëve nga revistat) dhe me mjete tjera shprehëse, do të paraqesin një segment nga jeta e bashkësisë etnike:

- **Religjioni** (besimi, librat e shenjta, objektet e shenjta, traditat, festat);
- **Ushqimi** (ushqimet tradicionale kombëtare, ato të përditshme, festive, desertë, përgatitjet dimërore);
- **Kultura** (shkrimtarë, aktorë, këngëtarë, gazetarë, studiues).



Anëtarët e grupit, aktivitetin e tyre mund ta ndajnë sipas afiniteteve të veta dhe sipas njohurive që i posedojnë për një lëmi të caktuar.

Pas përpunimit të portfoliove, secila paralele duhet të përgatis prezantim para paraleles tjetër, por nga bashkësia tjetër etnike. Në këtë mënyrë nxënësit do të kenë mundësi që më shumë të njoftohen me ato segmente nga jeta e bashkësisë tjera etnike.

□ **KONFLIKTIN TA ZËVENDËSOJMË ME BASHKËPUNIM**

■ **Teknikat e punës: puna me çifte, të shkruarit e tekstit sipas vizatimit**


Ky aktivitet mund të realizohet me nxënësit, sidomos duke filluar nga grupi i parapërgatitur e gjer me nxënësit e klasës së IV, me ç'rast duhet të aftësohen qasja (akcesi), pyetjet dhe kërkesat sipas moshës së nxënësve

Në paralele formohen çifte nxënësish. Secili çift do të marr 6 pjesë të përziera kompozicionale nga tregimi "Gomarët e shkathtë". Çiftet e nxënësve në fillim duhet t'i radhisin sipas radhitjes logjike të ngjarjes, mandej të përpilojnë tregimin duke u përgjigjur në këto pyetje:

- *Çfarë problemi patën gomarët?*
- *Si tentuan ta zgjidhin problemin?*
- *A patën sukses? Pse nuk patën?*
- *Si zgjodhën problemin?*
- *A e fituan atë që e dëshiruan?*



Disa nga nxënësi do ta lexojnë atë që e kanë shënuar, mandej bashkërisht do të diskutojnë dhe në fund do të vijnë në përfundim se konflikti është problem i përbashkët i të dy palëve dhe ai mund të zgjidhet vetëm me angazhim dhe bashkëpunim të përbashkët.



Kompozicioni i fotove nga tregimi "Gomarët e shkathët"

2.2 PËRMBAJTJET E REALIZUARA NËPËRMES VEPRIMTARIVE EDUKATIVE-ARSIMORE

Mësimdhënësit, respektivisht ekipet e shkollës janë kyçur në projektin , Komunikimi ndëretnik dhe bashkëpunimi midis nxënësve në shkollat me përzierje etnike", realizuan shumë aktivitete dhe punëtori në suazat veprimtarisë edukative-arsimore jashtë mësimin. Këto aktivitete u realizuan në mënyrë interdisciplinore (dy më shumë seksione apo fusha).

2.2.1 AKTIVITET E LIRA PËR ZGJERIMIN E NJOHURIVE: LETËRSIA, GAZETARIA, GJUHA, SEKSIONI PËR FOTOGRAFË DHE NGA FUSHA E INFORMATIKËS

Takimi me shkrimtarë nga nacionalitetet e ndryshme

„Para se gjithash njerëzit janë qenie ndjenjash dhe jo kuptimit. Prandaj janë të nënshtruar në paragjykime plot me krenari dhe mendjelartësi...”

Anëtarët e seksionit të letërsisë dhe gazetarisë, organizuan takime me shkrimtarë të nacionalitetit maqedonas dhe shqiptar, Pero Milenkovski dhe Punëtorie Ziba-Muça. Anëtarët e seksionit të gazetarëve përgatiten dhe parashtruan pyetje lidhur me motivimin, inspirimin, prirjen dhe talentin, lidhshmërinë e tyre me letërsinë dhe rëndësinë e krijimtarisë letrare:

Shkrimtarët, secili në gjuhën e vet, paraqiten opusin e tyre letrar Ata folën për vet-veten, për vjershat e para të tyre, për dashurinë ndaj fjalës së shkruar etj. Takimi pati një shenjë të mrekullueshme shoqërimi. Erdhëm në përfundim se poetët kanë inspirime të njëjta dhe të përbashkëta: dashurinë, fatin, dhembjen, mallin, ndarjen, natyrën etj. Me fuqinë e prirjeve poetike, edhe pse secili në gjuhën e vet, poetët në mënyrë poetike e bënë të kuptueshme për të gjithë.

Nxënësit pyetën edhe për fjalën shkruar të fshehtë, lexuan vjershat e tyre dhe kërkuan nga ta që t'i shprehin mendimet e tyre për ato.



Përmbledhje recetash nga ushqimet tradicional maqedonas dhe turk

„Armiqësinë shënojeni në rërë që ta fshijë fryma për t'u harruar, ndërsa miqësinë në gurrë që të mbetet e shënuar përgjithmonë.“

Për realizimin e këtyre aktiviteteve u kyçën nxënës, mësimsdhënës, prindër, seksioni i gjuhëtare, të informatikanët e rinj dhe seksioni i fotografëve.

Grupi i nxënësve të nacionaliteti maqedonas dhe turk mbledhën re-ceta për ushqimet e vjetra tradicionale maqedonase dhe turke, i zgjedhën recetat më të vjetra dhe më tipike, gjë që nga ato formuan një përmbledhje recetash.

Nxënësit nga seksioni i gjuhëtarëve, së bashku me mësimsdhënësit përgjegjës për organizimin e seksionit, i lekturuan tekstet e recetave në gjuhën maqedonase dhe turke.

Nxënësit nga seksioni i fotografëve i fotografuan ushqimet e përgatitura, mandej për përmbledhjen e recetave bënë një përmbledhje të fotografive.

Informatikanët e rinj i shënuan recetat, i përpunuan me kompjuter, kështu që përgatitën **Përmbledhjen e recetave nga ushqimet kombëtare tradicionale.**




БАНИЈА

- ◆ 500 гр. кора
- ◆ 300 гр. сирене
- ◆ 250 мл. кисело млеко
- ◆ 1 чаша млеко за јадење
- ◆ 3 јајца

Приготвување :

Јајцата, киселото млеко и миското за јадење ги мешаме. Секоја кора ја шпрскуваме со филот и врз него ставаме сирене. Постапката ја повторуваме додека корите не свършат. Готовата баница се става да се пече околу 30 мин. на 250 C.



PIDE

- ◆ 500 g yufka
- ◆ 300 g peynir
- ◆ 250 g yoğurt
- ◆ 1 bardak zeytinyağı
- ◆ 3 adet yumurta

HAZIRLAMAK:

Yumurtu, yoğurt ve zeytinyağı derin bir kapta karıştırın. Her yufkadan üçerine hamur ve peynir atınız. Pideyi 250 derecelik fırında 30 dakika pişirin.

2.2.2 AKTIVITET E LIRA KULTURO-ARTISTIKE: SEKSIONI I ARTIT FIGURATIV DHE FOLKLORIK

Seksioni i artit figurativ

Ky seksion është i formuar nga nxënës me përkatësi të ndryshme etnike, me aplikimin e teknikave të ndryshme të artit figurativ, punuan vizatime ku janë paraqitur veshjet popullore nga bashkësitë etnike, gjërat e ndryshme shtëpiake tradicionale dhe instrumentet popullore. Pastaj kanë punuar edhe gjëra të ndryshme me glinë duke i zbukuruar ata me vizatime të ndryshme ku kanë paraqitur elemente folklorike të bashkësive etnike.

Nëpër mes këtyre aktiviteteve, nxënësit jo vetëm që u njoftuan drejtë për së drejti, komunikuan dhe bashkëpunuan, por fituan edhe njohuri nga ornamentika dhe ngjyrat e secilës kulturë nacionale.

Krijimet e artit figurativ janë ekspozuar nëpër muret e korridoreve të shkollës që ishte një kontribut për pamje estetike të shkollës. Nxënësit e seksionit të artit figurativ të një shkolle tjetër i ngjyrosen dhe dizajnuan karriget e oborrit dhe rrethoret e shkollës.

Seksioni folklorik

Aktivitet e nxënësve nga seksioni folklorik përbëhen nga të mësuarit e valleve popullore të bashkësive etnike. Ky seksion ka punuar si i pavarur dhe ndaras me nxënës në orët e mësimit klasor dhe atij lëndorë. Ata i mësuuan vallet optan-toptan, pemben dhe pajdushkën.

Prezantimin e valleve para prindërve u bë edhe me veshjen kombëtare.

Duke i mësuar vallet nxënësit mësuuan më shumë për secilën valle, se kur luhet dhe se çfarë paraqitet në të, për veshjet popullore dhe pjesët e tyre.

„Jeto për shkak të tjerëve në qoftë se dëshiron të jetosh për vete”.



2.2.3 AKTIVITETET E LIRA PRODHUESE NGA PUNA E TIPIT INDUSTRIALE- ZANATÇINJSH

„Të kesh kohë për punë, sepse ajo është çmimi i suksesit.”

Në qoftë se ky grup i aktiviteteve ofron mundësi të ndryshme të llojllojshme për zhvillimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndëretnik, nxënësit u përcaktuan vetëm për përpunimin e suvenirëve, gjërave zbukuruese nga glina ky nxënësit vizatuan motive folklorike. Nxënësit me mësim

klasor punuan gjerdan nga brumi me forma të ndryshme.

Punimet u prezantuan para prindërve të cilët ua shitën për një shpërblim simbolik, kurse mjetet e mbledhura u shfrytëzuan për të blerë material punues. Duke punuar në këto aktivitete nxënësit u shoqëruan, shkëmbyen ide, bashkëpunuan dhe u shpërblyen në mes vete.



PUNA E DOBISHME SHOQËRORE-PRODHUESE DHE PUNË TJERA

„Miku i singertë është më i mirë sesa farefisi.”

3.1 RREGULLIMI ESTETIK I HAPËSIRËS, ZBUKURIMI I KORRIDOREVE DHE OBORRIT SHKOLLOR

Zbukurimin e korridoreve dhe rregullimin e oborrit, nxënësit e kryen në bashkëpunim me seksionin për art figurativ dhe lulishte.

Me punimet e artit figurativ i zbukuruan muret e korridoreve, kurse me sendet e ndryshme shtëpiake tradicionale që janë mbledhur, formuan dhe rregulluan etno-rafte.



Duke mbledhur gjëra të ndryshme shtëpiake të bashkësive etnike dhe duke rregulluar etno-rafte, nxënësit u njoftuan me ngjashmëritë dhe dallimet e sendeve, të cilat kanë pasur përdorim të njëjtë.

BASHKËPUNIMI I SHKOLLËS ME MJEDISIN LOKAL

4.1 BASHKËPUNIMIN ME FAMILJE

Organizimi dhe realizimi i prezantimit të ushqimeve nacionale

Në mënyrë aktive edhe prindërit u kyçën në përgatitjen e „Përmbledhjes së reçetave për ushqime tradicionale kombëtare“. Ata, fëmijëve të vet u treguan reçeta, pastaj vullnetarisht, sipas zgjedhjes së vet, përgatitën nga një ushqim kombëtar apo nacional që e prezantuan në manifestimin përfundimtar të projektit. Në manifestim morën pjesë edhe një numër mysafirësh si: anëtarët e këshillit drejtues të shkollës, prindër, mësimdhënës, përfaqësues të vetëqeverisjes lokale dhe mediumet.

Në organizimin dhe realizimin e këtij aktiviteti, u shoqëruan nënat maqedonase dhe turke, bashkëpunuan dhe u morën veshtë se cila dhe çka do të përgatisë që sofrat të jetë sa më e pasur dhe me lloje të ndryshme ushqimi.



Vizita nëpër familje me përkatësi të ndryshme etnike

Grupe nxënësish vizituan familje, si për shembull, nxënësit nga përkatësia etnike shqiptare vizituan familje maqedonase, kurse nxënësit maqedonas vizituan familje shqiptare. Vizitave u paraprinte një përgatitje serioze. Mësimdhënësit biseduan me nikoqirët, për atë se çka do të kërkohet nga ata, që gjatë vizitës së nxënësve çka duhet ta bëjnë, cilëve pyetje duhet t'u përgjigjen dhe si duhen të përgjigjen. Nxënësit bashkë me mësimdhënësit përgatiten pyetje për biseda me

nikoqirët e shtëpisë. Nxënësit kanë parashtruar pyetje për jetën e tyre me fqinjët, për festat që i festojnë, pse dhe si i festojnë ato, ushqimet që i përgatisin me rastin e festave dhe gostive tjera.

Vizitat u realizuan në kohën e festave të mëdha fetare, si për shembull tek të krishterët -Pashkët, kurse tek myslimanët- Bajrami. Kështu nxënësit patën mundësi që të jenë në rolin e mysafirëve dhe të përjetojnë dhe ndejnë atmosferën festive në familje.

VIZITË NË FAMILJE MAQEDONASE

Në vazhdimësi me aktivitetin tonë për realizimin e projektit për bashkëpunim ndëretnik, vendosëm që të vizitojmë familje maqedonase me qëllim që të mësojmë për regjionin dhe traditat e familjes maqedonase. Pyetjet që u parashtruan u përgatitën paraprakisht, dhe pyetja e parë që parashtruam ishte për shoqërimin me miqtë dhe fqinjët. Ata na u përgjigjen shumë shkurt. „Ne nuk duam njerëzit t'i dallojmë as nga përkatësia etnike por as nga ajo fetare. Ne duam që të shoqërohemi dhe të kemi miqësi me të gjithë". Përgjigjen që e morëm ishte e shkëlqyeshme dhe për ne ishte një mësim shumë i mirë. Neve na interesonin traditat e tyre, ndërsa ata na treguan për festat, traditat dhe na sqaruan se çka domethënie ka ngjyra e kuqe që i ngjyrosin vezët me rastin e festës së Pashkëve. Ajo simbolizon pranverën e përgjakur të Krishtit. Lidhur me festat na treguan shumë gjëra, kurse si festa më të rëndësishme i theksuan festat e Krishtlindjes dhe Pashkëve. Na treguan edhe për ushqimet e tyre tradicionale të cilat dominojnë: mishra të ndryshme, lloje të ndryshme sallatash, por me rëndësi ishte që sofra të jetë sa më me bollëk. Sa i përket traditave ata na rrëfyan se në shumë vise të ndryshme festat festohen me tradita të ndryshme.

Lidhur me jetën dhe traditat e familjes maqedonase mësuam shumë gjëra, gjë që edhe mbetëm shumë të kënaqur kur me rastin e festës së Pashkëve na dhanë vezë të ngjyrosura me ç'rast edhe shumë na gëzuan.

VIZITA NË FAMILJE SHQIPTARE

Si pjesë e programit tonë ka qenë edhe vizita në familje shqiptare me qëllim që më shumë të dimë për festat e tyre, dasmat dhe traditat e tyre, edhe pse pyetjet tona ishin të përgatitura që përpara. Ja si vijoi biseda jonë:

Pyetja: Sa anëtarë ka familja Juaj?

Përgjigja: Ne jemi katër anëtarë, kurse me ne, në banesë jetojnë edhe prindërit tonë.

Pyetja: A keni mirëkuptim me fqinjët e Juaj të cilët janë me përkatësi të ndryshme nacionale?

Përgjigja: Të gjithë ne këtu jetojmë bashkë, ne si fqinjë kemi mirëkuptim dhe nuk dallohemi nga njëri tjetri.

Pyetja: Na tregoni diçka për festat e dhe për ushqimet e Juaja tradicionale?

Përgjigja: Kemi tre festa fetare: Ramazanin, Fitër Bajramin dhe Kurban Bajramin, me rastin e të dy Bajrameve ne bëjmë bakllava. Me këtë rast gratë tona zgjohen herët në mëngjes, bëjnë bukë dhe gjëra tjera. Kurse burrat shkojnë në xhami.

Pyetja: Si duken dasmat e Juaja, a u përmbaheni tradita dhe zakoneve të vjetra tradicionale?

Përgjigja: Kjo më të vërtetë është pyetje interesante, prandaj për këtë temë mund të bisedohet më gjatë. Dasmat tona janë me tradita interesante, por gjeneratat e tashme të reja nuk u përmbahen atyre. Këto tradita ruhen akoma vetëm nëpër fshatra.

Në fund, ne mbetem të kënaqur nga përgjigjet dhe patëm fatin që mësuam diçka më shumë për traditat dhe zakonet tradicionale shqiptare, për festat e tyre, për dasmat dhe për të gjitha ato që na interesante me jetën e familjes shqiptare.

4.2 BASHKËPUNIMI I SHKOLLËS ME ORGANIZATAT TJERA

Vizitë kazermës „Goce Dellçev“ - njësisë për qëllime speciale

Vizita njësisë speciale u realizua sepse, ajo është e përbërë nga ushtarë me përkatësi të ndryshme etnike. Vizitën e përgatiti drejtori i shkollës me epërorin e kazermës.

Nxënësve iu tregua një film ku panë jetën ushtarake në kushte speciale. Gjithashtu, nxënësit panë se feja dhe përkatësia etnike nuk paraqesin asnjë pengesë në realizimin e detyrave të parashtruara në mbrojtjen e shtetit.



REZYME

Në këto faqe treguam aktivitetet e nxënësve të shkollave që kanë qenë të kyçur në projektin: „Komunikimi dhe bashkëpunimi ndëretnik midis nxënësve në shkollat e përziera etnike“. Përmendëm se qëllimet u arritën, por që të arrihet kontributi i përhershëm në zhvillimin e bashkëpunimit dhe tolerancës të bashkësive etnike në Republikën e Maqedonisë, nevojitet të punohet edhe më shumë, me këmbëngulje dhe në mënyrë permanente, të punohet për bashkëpunimin dhe tolerancën ndëretnike në mes nxënësve, nëpër shkollat fillore të shfrytëzohet secila mundësi dhe secili segment nga puna edukative-arsimore e shkollës.



Në vazhdim bashkëngjisim listën e aktiviteteve të cilat mund t'i realizoni me nxënësit e juaj në kuadrin e programit të aktiviteteve jashtë mësimore.

Aktivitetet, në qoftë se realizohen vetëm në atë kohë sa zgjasin projektet, atëherë ato do të japin vetëm rezultate privede, por në qoftë se ato do të zhvillohen rregullisht, atëherë ata do të japin rezultate të përhershme dhe efikase.

Me botimin e këtij publikimi dëshirojmë t'i stimulojmë dhe t'i motivojmë edhe shkollat tjera që janë me përbërje të përzier etnike që të tentojnë t'i realizojnë aktivitetet e ofruara.

Shpjegimi i aktiviteteve, në masë të madhe është marrë dhe transmetuar në mënyrë autentike nga raportet e ekipeve të shkollave, me qëllim që ata ta përjetojnë direktet dhe sa më afër.

LISTA E AKTIVITETEVE

- Përgatitja e **emblemës së shkollës**, që do të simbolizoj bashkimin në mes bashkësive etnike në shkollën e juaj.
- Përgatitja e **plakatit shkollor** (pan-karta) që do të simbolizoj bashkimin midis bashkësive etnike në shkollën e juaj.
- Të mësuarit e **valleve popullore të bashkësive të ndryshme etnike** me shpjegim për emrin e valles dhe për simbolikën e saj.
- Rregullimi i **rafteve në korridorin e shkollës** me veshje popullore tradicionale dhe me sende të ndryshme shtëpiake.
- Rregullimi i **broshurës me ushqime tradicionale kombëtare**.
- Organizimi i **ekspozitës për ushqimet tradicionale kombëtare**.
- Organizimi i **ekspozitës për punime punëdore**.
- **Shkëmbim i vizitave nëpër shtëpitë e nxënësve** me përkatësi të ndryshme etnike me rastin e festave tradicionale dhe manifestimeve tjera. Të gjitha këto duhet të përcillen duke sqaruar se pse festohen, të sqarohen disa tradita, rituale dhe mënyra.
- **Vizitë objekteve fetare** dhe bisedë me klerin fetar. Me këtë rast duhet të sqarohet edhe simbolizimi dhe arkitektura e objekteve, pjesët e tyre, ritualet etj.
- **Përpunim i përmbledhjeve portfolio nga objektet fetare** dhe përmendoreve të ndryshme nga feja e krishterë dhe ajo islame të cilat gjenden në afërsi të vendit

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
1. Nocionet me të cilët mund të kuptohet më mirë toleranca ndëretnike	5
2. Shkolla me përbërje etnike të përzier është punëtori ku mund të mësohet dhe kultivohet komunikimi dhe bashkëpunimi ndëretnik	7
2.1 Përmbajtjet e realizuara të orës të udhëheqësit të paraleles	7
2.2 Përmbajtjet e realizuara përmes veprimtarisë jashtë procesit edukative-arsimorë	20
2.2.1 Aktivitetet e lira për zgjerimin e njohurive: nga seksionet letrare, gazetareske, gjuhësore, fotografike dhe informatikanëve të rinj	20
2.2.2 Aktivitetet e lira kulturo-artistike: nga seksioni i artit figurativ dhe folklorik	22
2.2.3 Aktivitete të lira të punës prodhuese dhe punëve tjera të tipit industriale-zanatçinj	23
3. Puna prodhuese shoqërore dhe ajo shfrytëzuese	24
3.1 Formësimi estetik të hapësirave, zbukurimi i korridoreve dhe oborrit shkollor	24
4. Bashkëpunimi i shkollës me mjedisin lokal	25
4.1 Bashkëpunim me familjet	25
4.2 Bashkëpunimi i shkollës me organizata tjera	28
Rezyme	29

■ ■ ■

Botues:

Qendra maqedonase për arsimim qytetar (QMAQ)
ul. "29 Noemvri" 4-B/1
1000 Shkup

■ ■ ■

***SHKOLLA ME PËRBËRJE ETNIKE TË PËRZIER
- PUNËTORIA KU MËSOHET DHE KULTIVOHET KOMUNIKIMI
DHE BASHKËPUNIMI NDËRETNIK***

■ ■ ■

Përkthyes:

Arijeta Xhemaili

■ ■ ■

Dizajni grafik:

Biljana MIHAJLOVSKA

■ ■ ■

Tirazhi:

230 ekzemplarë

